



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë

Datë 16.07.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT NË FORMËN E TRANSFERTËS TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETITIT PËR MBROJTJEN CIVILE NË KODIN AD, PËR OBJEKTIN “MURE MBAJTËS NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 1 DHE NR. 2

Baza ligjore:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nr.429/6 prot datë 15.04.2026 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” protokolluar me tonën nr.5138 prot datë 20.04.2026, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, Marrëveshjen Kuadër nr.1298/19 prot datë 27.11.2025, me objekt ”Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, rezidenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rugore në territorin e Bashkisë Durrës”, kontrata e shërbimit nr.210/32 prot datë 03.06.2026 me objekt “Studim projektim ndërhyrje emergjente rehabilituese-përforcuese për rrëshqitjet e terrenit në njësitë administrative nr.1, nr.2, nr.4, nr.6, Sukth, Manëz, Katund i Ri dhe Rrashbull”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve, Infrastruktura Publike dhe Transportit Publik dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile, në kodin AD, në vlerën 15,424,018 lekë, për realizimin e projekt-preventivave "Mure Mbjajtëse", sipas tabelës së mëposhtme.

Titulli i projektit	Vlera e projektit në lekë
Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	14,976,229
Mbikqyrje objekti: Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	389,382
Koalodim objekti: Mure mbajtës në njësinë administrative nr.1 dhe nr.2	58,407
Total	15,424,018

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Transfertë e kushtëzuar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës, NJA 1 dhe 2.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, u mbledhë më datë 16.07.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 5 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:


Komisioni u mbledh për diskutim të pikës nr 5 të rendit të ditës, me qëllim të diskutimit në prani të stafit të SHS/CSD, propozon tërësinë e projektve vendim të mbledhjen e datës 17.07.2026.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë

1	Kryetar	Mirela Shala	
2	Zv/Kryetar	Xhiliola Doçi	
3	Sekretar	Zhuljeta Ngota	
4	Anëtar	Rolant Xhelilaj	
5	Anëtar	Ervis Bekteshi	